



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR  
TIRANË

Nr.19 Regj.Them

Datë: 07 qershor 2021

Datë regjistrimi: 02.06.2021

**VENDIM**  
**“PËR BASHKIMIN E ÇËSHTJEVE”**

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim më datë 02.06.2021, ora 13.25, çështja që i përket:

**Paditës:** Partia Lëvizje Socialiste për Integrim

**I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Tiranë

**Kundër:** Vendimit nr.93 datë 31.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me anën e të cilit është vendosur:  
1.Rrëzimin e Kërkesës Ankimore Nr.48, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;  
2.Lënien në fuqi të vendimit Nr.346, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendimin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

**Objekti:** Ndryshimin i vendimit nr.93, datë 31.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

**Baza ligjore:** Neni 145 e vijues Kodit Zgjedhor të RSH.

Më datë 03.06.2021 u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe sipas tij trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët;

- 1) AsimVokshi (relator),
- 2) AlmaKolgjoka (anëtare),
- 3) Edlira Petri (anëtare),
- 4) Sokol Ibi (anëtar),
- 5) EsmeraldaXhili (anëtare).

Rezulton se më datë 07.06.2021, ora 08.50 nëpërmjet shqërbimit postarështë paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Apelit çështja me nr.21 akti, datë regjistrimi 07.06.2021 që i përket:

- Paditës:* Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN)
- I paditur:* Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Tiranë.
- Palë të Interesuara:* Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).  
Partia Socialiste e Shqipërisë
- Objekti:* 1.Kundërshtimi i vendimit të datës 31.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve KAS për rrëzimin e kërkesës ankimore nr.43 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN).  
2.Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Korçë.  
3.Urdhërimin e përsërisjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Korçë.
- Baza ligjore:* Nenet 1, 18, 35, 42, 45, dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë;  
Nenet 6, 8, dhe neni 3, Protokoli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;  
Pikat 27 dhe 49 te Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore;  
Nenet 136, 137, 145, 152, 153, 156, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor;  
Nenet 14, 223, dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile;  
Nenet 6 dhe 7 të Ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;  
Nenet 3 dhe 6 të Vendimit nr.9 date 24.12.2020 te KQZ-së.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, vlerëson se çështja nr.21 akti, datë regjistrimi 07.06.2021 ka lidhje për nga objekti me çështjen e regjistruar më parë me nr.19 akti, datë regjistrimi 02.06.2021, për të cilën është hedhur shorti për përcaktimin e trupës gjyqësore. Në zbatim të neneve 57, 158/a(ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor, çështja e paraqitur më pas me nr.21 akti, datë regjistrimi 07.06.2021, do të bashkohet me çështjen e regjistruar më parë me nr.19 akti, datë regjistrimi 02.06.2021 dhe do të gjykohen në një gjykim të vetëm.

Në këto kushte, në zbatim të neneve 57, 158/a(ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

**VENDOSA:**

1. Bashkimin e çështjes së paraqitur më pas me nr.21 akti, datë regjistrimi 07.06.2021, me paditës Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN), me çështjen zgjedhore të regjistruar më parë e cila mban nr.19 akti, datë regjistrimi 02.06.2021, me paditës Partia Lëvizje Socialiste për Integrim.
2. Ngarkohet sekretaria gjyqësore sëbashku me punonjësit gjyqësorë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, t'i njoftojnë këtë vendimbashkimi palëve, si dhe subjekteve të tjera të interesuara që kanë qenë pjesëmarrëse në procedurën e ankimit administrativ pranë KAS, për vendimmarrjen objekt gjykimi.
3. Tiranë më 07 qershor 2021.

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES  
GJYQTAR RELATOR**

**Asim VOKSHI**



